



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Divizioni për Komunikim me Publikun

THIRRJE PËR APLIKIM

Për Pagesa Direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë dhe therret e raportuara të gjedhit për tremujorin e parë (TM1) 2018

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të vazhdojë të mbështesë sektorin e blegtorisë përmes pagesave direkte për qumësht/litër dhe therret e raportuara të gjedhit.

Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët / aplikuesit që aplikojnë për Pagesa Direkte – qumësht sipas kategorive të cilësisë:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të jenë të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (personat juridik);
- Të jenë të regjistruar në sistemin e Identifikimit dhe të Regjistrimit të kafshëve në AUV;
- Ta kenë kontratën për shitjen e qumështit me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose me ndonjërin nga pikat grumbulluese të qumështit, të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë;
- Të ofrojnë dëshmi të lëshuar nga laboratorit i AUV-së për cilësinë e qumështit të dorëzuar në qumështore ose pikën grumbulluese të qumështit, i pranueshëm për pagesë është qumështi i kategorive: Ekstra, Klasi i Parë dhe i Klasi i Dytë;
- T'i dorëzojë më së paku 1500 litra qumësht për 3 (tre) muaj (sipas tremujorëve të vitit kalendarik);
- Të ofrojnë dëshmi për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar) në ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose me ndonjërin nga pikat grumbulluese të qumështit, të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë;
- Të ofrojnë dëshmi bankare për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar).

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës (për personat fizik) ose kopjen e regjistrimit të biznesit (për persona juridik), dokumentin i cili vërteton se kush e ka autoritetin që të nënshkruajë për kompaninë;
- Konfirmimin nga banka për xhirologarinë bankare të aplikuesit;
- Kopjen e listës së verifikimit të gjedheve të lëshuar nga sektori për Identifikim dhe Regjistrim (I&R) në kuadër të AUV-së;
- Kopjen e kontratës për furnizim me qumësht, të lëshuar nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose nga pikat grumbulluese të qumështit, të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë;

- Dëshminë për sasinë e qumështit të dorëzuar sipas cilesise, në qumështore ose në pikat grumbulluese të qumështit, të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë;
- Dëshminë nga banka për pagesën e bërë nga qumështorja për sasinë e dorëzuar;
- Dëshminë për pjesëmarrjen në projektin "Transparenca dhe neutraliteti i marrjes së mostrave të qumështit";
- Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-se (vetëm për personat juridikë)
- Dëshminë për pagesën e tatimit mbi pronë.

Mënyra subvencionimit:

Subvencionimi do të bëhet për litër të qumështit të dorëzuar në qumështore të licencuar ose në pikat grumbulluese të qumështit, të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë, sipas kategorive:

1. Ekstra klasë 0.06 €
2. Klasa e Parë 0.04 €
3. Klasa e Dytë 0.02 €

Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit që aplikojnë për Pagesa Direkte – therrjet e raportuara të gjedhit:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të jenë të licencuara nga AUV në kategorinë A, B, C dhe D
- Të raportojnë therrjet në bazën e të dhënave në Sektorin e Identifikimit dhe Regjistrimit në AUV, sipas dinamikës së paraparë të thertores;
- Gjendet duhet të jenë të matrikulluara me matrikull të Republikës së Kosovës;

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit/subjektit;
- Kopjen e licencës së lëshuar nga AUV-ja;
- Kopjen e certifikatës së biznesit dhe informatat e biznesit;
- Kopjen e certifikatës së numrit fiskal;
- Dëshminë/vërtetimin për obligimet e kryera ndaj ATK-së;
- Regjistrin e kafshëve të therrura, të lëshuar nga baza e të dhënave të sektorit të Identifikimit dhe Regjistrimit-AUV, të dëshmuar me pasaportën e kafshës së therrur;
- Dëshminë/fletëpagesën, me të cilën vërtetohet se është realizuar pagesa nga thertorja tek fermeri, në vlerë prej 30 €/krer gjedhe të therrur.

Mënyra e subvencionimit:

- Pagesa do të bëhet për krerë gjedhe të therrur, në vlerë prej 50 €/krer.
- Pagesës në vlerë prej 50 euro/krer u bëhet thertoreve përfituese;
- Therrtorët obligohen që vlerën e mjeteve prej 30 euro t'ia paguajnë fermerit në momentin e therrjes së gjedhit. Ndërsa, vlera e mjeteve prej 20 euro i mbetet thertores për shërbimin e therrjes.

Mënyra e aplikimit:

Aplikimi bëhet në Drejtorinë Komunale për Bujqësi.

Gjatë procedurës së kontrollit, në rast të gjetjes së shkeljeve do të aplikohen masa ndëshkimore, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ për pagesat direkte në lëmin e bujqësisë.

Periudha e aplikimit:

Afati i aplikimit fillon nga data 16.04.2018 dhe mbaron me datë 16.05.2018